




Pasqyra Makroekonomike publikohet nga Ministria e Financave çdo tre muaj dhe ka për qëllim informimin mbi zhvillimet tremujore ekonomike në Kosovë.

## Sektori Real


Ekonomia vendore pritet të rritet me rreth 4.6% përgjatë vitit 2018, rritje kjo e ndikuar kryesisht nga rritja e investimeve në veçanti atyre publike, pasuar nga rritja e kreditimit me norma të ulëta të interesit (përfshirë këtu edhe mundësinë kreditimit të sektorit privat nga IFN). Kontribut të veçantë në këtë rritje të aktivitetit ekonomik vlerësohet të ketë ardhur nga reformat fiskale si dhe reformat strukturore të ndërmarra përgjatë periudhës paraprake. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (shih grafikun 1), BPV në tremujorin e katërt të vitit 2017 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak ka shënuar rritje prej 3.2% ne terma real, ndërsa viti 2017 (sipas të dhënave preliminare të ASK-së) në krahasim me vitin 2016 ka shënuar rritje vjetore në vlera reale prej mbi 3.7%. Të gjitha parashikimet, ato të Bankës Botërore, Fondit Monetar dhe Ministrisë së Financave, kanë vlerësuar pritjet për rritje në vitin 2017 në mbi 4%.

Grafiku 1. BPV reale, sipas qasjes së shpenzimeve



Sa i përket lëvizjeve të çmimeve, përgjatë periudhës raportuese, indeksi i çmimit të konsumatorit (IÇK) ka vazhduar të tregojë një rritje të lehtë nga Janari që ishte negativ, në Mars që rezultoi me 0.1%, duke mbajtur nivelin të njëjtë me tremujorin e parë të vitit paraprak. Tendencë në rritje vazhdon që nga viti 2016, edhe në 2018 parashihet vazhdimësi e një rritje të çmimeve nga viti paraprak.

Grafiku 2. Indeksi i Çmimit të Konsumatorit



Çmimet e ushqimit dhe pijeve joalkoolike patën një ngritje në këtë tre muaj prej 0.6% në mesatare dhe siç mund të shihet edhe nga grafiku 2, IÇK në fund të periudhës raportuese ka filluar të tregojë tendencë rritëse, kjo si rezultat i fillimit të ngritjes së çmimeve botërore të ushqimit dhe transmetimi i këtyre presioneve inflacioniste në vend.

Për më shumë, si tregues gjithashtu i rëndësishëm i zhvillimeve në sektorin real mund të cilësohen numri i bizneseve të reja të regjistruara dhe perceptimet e bizneseve për ambientin e përgjithshëm biznesor. Në këtë drejtim, nga të dhënat e ASK-së (Tabela 1)


vërejmë se në Kosovë deri në fund të muajit Mars 2018 u regjistruan gjithsej 2556 biznese të reja, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak janë 294 biznese të reja të regjistruara më pak. Inkurajues është fakti i rritjes së biznese të reja te sektori i prodhimit, derisa një rënie në regjistrimin e bizneseve në fillim vit, në sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë, bujqësi, pylltari dhe peshkatari, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo mund të kuptohet si rrjedhojë e periudhë kohore me aktivitetin ekonomik i cili është më i lartë zakonisht në sezonin e verës. Këtë tremujor të fillim vitit 2018 bizneset me numër më të madh të regjistruara mbeten në sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë, prodhim, ndërtimtari dhe akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim.

Tabela 1. Numri i bizneseve të regjistruara

Sektori i regjistrimit të biznesit	TM1 2017	TM1 2018
Tregti me shumicë dhe pakicë	799	722
Prodhim	265	316
Bujqësi, pylltari dhe peshkatari	350	127
Ndërtimtari	269	266
Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	261	247
Të tjera	906	878
Totali	2850	2556


Pasi që pritjet dhe vlerësimet e bizneseve vendore mbi pritjet ekonomike dhe të bërit biznes janë tregues të rëndësishëm për ecuritë ekonomike, në vijim janë të paraqitura të dhënat nga Oda Ekonomike e Kosovës të cilat pasqyrojnë pozitën e sektorëve sipas vlerësimeve të bizneseve.

Grafiku 3. Klima e biznesit në TM1 2017



Të dhënat e tremujorit të parë të vitit 2017 dhe 2018 tregojnë se përshtypjet e shumicës së bizneseve lidhur me klimën e të bërit biznes kanë qenë pozitive. Megjithatë, kjo nuk vlen edhe për sektorin e shitjes me shumicë dhe ndërtimtarisë të cilat në këtë tremujor janë të rreshtuara në klimë pozitive por me përkeqësim. Sektori i perpunimit, shitjes me pakicë dhe i shërbimeve, paraqesin përmirësime në pritshmëritë e tyre dhe vlerësime të tilla mund të vijnë për shkak të fillimit të sezonës së pranverës e cila ka ndikim tek sektorët e ndryshëm në përgjithësi.

Grafiku 4. Klima e biznesit në TM1 2018




Grafiku 5. Na prezanton pritjet e bizneseve mbi klimën që do të mbizotërojë për gjashtë muajt në vijim. Përshtypjet e bizneseve lidhur me klimën e të bërit biznes janë me disa ndryshime me pritjet

mbi klimën që do të mbizotërojë për muajt e ardhshëm.

Vlen të theksohet se në përgjithësi pritshmëritë e bizneseve janë pozitive por në kufi të asaj me përkeqësim dhe përmirësim, përveç sektorit të ndërtimitarisë e cila pritshmëritë i ka pozitive me përmirësim për sa i përket klimës që do të mbizotërojë në 6 muajt e ardhshëm.

Grafiku 5. Pritjet e bizneseve në TM1 2018 për gjashtë muajt e ardhshëm



### Sektori i Jashtëm

Importi i produkteve vazhdon të ketë trend pozitiv, duke shënuar një rritje në total në raport me periudhën e njëjtë të vitit të mëparshëm. Siç mund të shihet nga Tabela 2, deri në fund të TM1 të këtij vit u importuan mallra në vlerë prej mbi 655 milionë euro, apo një rritje prej 8% të importit total në krahasim me tremujorin e parë të vitit 2017.

Tabela 2. Importi sipas produkteve, në '000 euro

Kategoria	TM1 2017	TM1 2018
Ushqim, pije, duhan	76,549	74,862
Produkte minerale	96,153	100,504
Metale bazë dhe artikujt prej tyre	53,104	73,848
Makineri, pajisje makinerie e elektrike	71,583	78,068
Të tjera	312,043	328,438
<b>Totali</b>	<b>609,432</b>	<b>655,720</b>

Në tabelën 3. paraqiten të dhënat e importit sipas shteteve dhe vërehet se afërsisht 43% e importit total vjen nga shtetet e Bashkimit Evropian. Ndërsa, vendet

me pjesëmarrje më të lartë të importit janë Serbia, Gjermania, Kina dhe Turqia. Sa i përket importit nga Gjermania, ai ka shënuar rënie në këtë tre muajor prej 4% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, ndërsa më së shumti kemi rritje të importit nga Kina dhe Turqia në TM1 2018 krahasuar me TM1 2017.

Tabela 3. Importi sipas shteteve, në '000 euro

Shteti	TM1 2017	TM1 2018
Gjermania	77,904	74,509
Italia	35,653	36,219
Serbia	95,455	97,602
Turqia	56,420	60,183
Kina	53,308	63,674
Të tjera	290,692	323,533
<b>Total</b>	<b>609,432</b>	<b>655,720</b>

Në anën tjetër, përgjatë tremujorit të parë në vitin 2018 eksporti ka shënuar rënie në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të mëparshëm. Eksporti gjatë kësaj periudhe arrin vlerën e mbi 73.3 milionë euro, që në përqindje shënon rënie prej rreth 4%.

Tabela 4. Eksporti sipas produkteve, në '000 euro

	TM1 2017	TM1 2018
Produktet minerale	10,148	8,300
Metalet bazë dhe artikujt prej tyre	31,989	26,511
Plastika, goma dhe artikujt prej tyre	7,140	9,171
Të tjera	27,127	29,378
<b>Total</b>	<b>76,404</b>	<b>73,360</b>

Të dhënat nga tabela 4. paraqesin një rënie të dukshme në eksportin e metaleve në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Gjatë këtij tremujori kjo kategori përbën rreth 36% të eksportit total. Në këtë tremujor vërehet rritje në eksportin e produkteve të plastikës dhe gomës dhe produkteve minerale. Rreth 2/3 të e eksporteve kosovare u destinuan në shtetet e CEFTA-s dhe të BE-së.

Tabela 5. Eksporti sipas shteteve, në '000 euro


Shteti	TM1 2017	TM1 2018
Gjermania	4,398	5,161
Italia	1,738	1,484
Bullgaria	1,786	2,060
Shqipëria	11,599	12,494
Maqedonia	8,432	9,565
Serbia	5,882	5,323
India	9,779	8,842
Kina	2737	247
Te tjera	30,052	28,184
Total	76,404	73,360

Nga tabela 5. shihet rënie në eksport me vendet si Italia, Serbia dhe India. Mirëpo, vërehet rritje e eksportit në Bullgari dhe Gjermani, ndërkohë që vendet e CEFTA-s edhe më tutje vazhdojnë të mbesin partnerët kryesor për eksportin e mallrave.

## Sektori Fiskal


Të hyrat e përgjithshme buxhetore tregojnë një ngritje në tremujorin e parë të vitit 2018 krahasuar me atë të kaluar në periudhën e njëjtë. Kjo ngritje shënon normën prej 4% ku të hyrat nga Tatimet direkte janë për 9.1% më të larta kurse ato Indirekte për 3.5%. Kjo ngritje në arkëtim vjen si rezultat i aktivitetit të shtuar ekonomik në vend, rritjen e vëllimit të shpenzimeve te sektorit privat dhe publike, përmirsimin e ambientit të të bërit biznese dhe gjithashtu së efijencës së agjencive mbledhëse si rezultat i reformave strukturore të ndërmarra.

Grafiku 6. Të hyrat, në milionë euro




Ndërkaq, sa i përket shpenzimeve të përgjithshme, ato gjithashtu shënuan një ngritje prej 16.6% në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Këtu e vërejmë një ngritje më të theksuar të shpenzimeve kapitale(44%), ndërsa tek ato rrjedhëse me 12%.

Grafiku 7. Shpenzimet, në milionë euro



Për sa i përket deficitit primar, grafiku me poshtë na tregon se edhe deficitin primar është ngritur në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (e kjo si rrjedhojë e ngritjes së shpenzimeve për këtë periudhë).

Grafiku 8. Deficiti Primar, në milionë euro



## Sektori Financiar

Sektori financiar në Kosovë mbetet mirë i kapitalizuar, likuid dhe profitabil si rezultat i përforsimit të procedurave konservative ndaj riskut kreditor. Bazuar në të dhënat nga Banka Qendrore e Kosovës, depozitat në sektorin bankar shënuan një rritje prej 5.6% në raport me periudhën e njëjte të vitit paraprak. Përderisa, kreditë shënuan një ngritje të theksuar prej 10.4%

në krahasim me periudhën e njëjte të vitit 2017. Asetet totale shënuan rritje prej 5.5%, duke arritur në 3.87 miliardë euro në fund të periudhës raportuese.

Tabela 6. Depozitat dhe kreditë në sektorin financiar, kumulative, fundi i periudhës (në milionë euro).


	TM1 2017	TM1 2018
Depozitat	2912	3074
Kreditë	2295	2534
Asetet Totale	3670	3873

Tremujori i parë i vitit 2018 u karakterizua me një rënie të normës së interesit të kredive të reja, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Nga 7.25% në çerekun e parë të vitit 2017, norma zbriti në 6.3%. Ndryshim pozitiv shënoi edhe norma e interesit të depozitave të reja. Ajo shënoi rritje nga 0.95% (tremujori i parë 2017) në 1.11% (tremujori i parë 2018). Sipas të dhënave statistikore të Bankës Qendrore të Kosovës, sektori financiar vazhdon të mbetet një kontribuues i rëndësishëm në financimin e ekonomisë së vendit.


Krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2017, në tremujorin e parë 2018, kreditë shënuan rritje të përcjellura nga depozitat të cilat gjithashtu shënuan rritje. Ndryshime të tilla janë indikatorë të mirë që sektori bankar vazhdon të mbetet mirë i kapitalizuar. E tërë kjo si rezultat i përpjekjes për të ndjekur politikën e reformave të vazhdueshme për stabilitet makroekonomik dhe zhvillim financiar. Në grafikun 10, janë të paraqitura zhvillimet e depozitave dhe kredive ku vërehet një trend gradual në ngritje.

Normat e interesit të kredive të reja shënuan rënie gjatë tërë vitit 2017, krahasuar me vitin paraprak 2016. Norma mesatare ra nga 7.47% në 6.83% përgjatë viteve 2016 dhe 2017. Në anën tjetër, norma e interesit tek depozitat e reja gjatë vitit 2017 shënoi një ngritje prej 0.03 pikë të përqindjes; nga 1.01% në 2016 në 1.04% në vitin 2017.

Grafiku 9. Trendi i normave të interesit dhe depozitave



Grafiku 10. Trendi i kredive dhe depozitave



Tabelë përmbledhëse

Përshkrimi	Njësia	2015	2016	2017				2018
				TM1	TM2	TM3	TM4	TM1
<b>SEKTORI REAL</b>								
Bruto Produkti Vendor	çmime konst., ndryshimi në %	4.0	3.9	2.7	4.3	4.4	3.2	:
IÇK	ndryshimi në %	-0.5	0.3	1.6	1.9	1.7	0.7	0.0
Ushqimi dhe pijet	ndryshimi në %	0.4	-0.4	1.0	1.9	1.4	1.9	0.6
Çmimet e importit	ndryshimi në %	-1.2	-2.5	5.2	4.3	4.2	2.5	:
Çmimet e prodhimit	ndryshimi në %	2.7	-0.1	0.9	5.5	5.6	1.6	:
<b>TREGU I PUNËS</b>								
Norma e punësimit	ndryshimi në %	25.2	28.0	28.9	29.9	30.4	29.8	:
Norma e papunësisë	ndryshimi në %	32.9	27.5	30.5	30.6	30.2	30.6	:
<b>SEKTORI I JASHTËM</b>								
Importi i mallrave	c.i.f., mil. euro	2635	2790	609	787	821	830	656
Eksporti i mallrave	f.o.b., mil. euro	325	310	76	103	105	94	73
Bilanci tregtar	mil. euro	-2309	-2480	-533	-684	-716	-736	-582
Importi i mallrave dhe shërbimeve	mil. euro	2926	3091	665	853	953	899	:
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	mil. euro	1274	1439	235	305	874	296	:
Bilanci i llogarisë rrjedhëse	mil. euro	-497	-481	-168	-250	238	-233	:
Bilanci i llogarisë rrjedhëse	% e BPV	-8.6	-7.9	-2.7	-4.0	3.8	-3.7	:
Investimet e Huaja Direkte	bilanci, mil. euro	309	220	65	84	66	74	:
Remitancat	bilanci, mil. euro	609	636	149	183	183	194	:
<b>SEKTORI FISKAL</b>								
Të hyrat e përgjithshme <i>prej të cilave:</i>	mil. euro	1457	1596	354	415	476	436	368
Të hyrat nga tatimet direkte	mil. euro	198	232	57	62	60	59	63
Të hyrat nga tatimet indirekte	mil. euro	1107	1227	253	321	380	361	262
Shpenzimet e përgjithshme <i>prej të cilave:</i>	mil. euro	1551	1658	349	421	422	549	407
Shpenzimet rrjedhëse	mil. euro	1149	1221	286	315	296	386	320
Shpenzimet kapitale	mil. euro	404	444	56	103	121	191	81
<b>SEKTORI FINANCIAR</b>								
Depozitat	mil. euro	2703	2898	2912	2888	3047	3093	3074
Kreditë	mil. euro	2020	2230	2295	2391	2407	2485	2534
Asetet totale të sektorit financiar	mil. euro	3385	3637	3670	3671	3811	3876	3873
Norma e interesit në kredi	%	8.3	7.5	7.3	6.7	6.6	6.8	6.9
Norma e interesit në depozita	%	0.9	1.01	0.9	1.0	1.1	1.1	1.1
Norma e këmbimit	EUR/EUR	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0
Norma reale efektive e këmbimit	indeks	104.7	104.6	105.9	104.6	104.8	104.5	104.9

Burimet: Agjencia e Statistikave të Kosovës  
Banka Qendrore e Kosovës  
Thesari i Kosovës (Ministria e Financave)  
Oda Ekonomike e Kosovës

(: ) – nuk ka të dhëna; në këto raste, të dhënat janë të disponueshme vetëm për tremujorin si tërësi \* të dhënat nuk janë të gatshme në kohën e publikimit të kësaj Pasqyre/Diskrepancat e mundshme me publikime tjera të Njesisë vijnë si pasojë përpunimit të të dhënave nga BQK, pasuar edhe me revidim historik.

*Përdorimi i të dhënave nga ky publikim lejohet vetëm me citimin e burimit. Pasqyra publikohet çdo tremujor dhe çdo përmirësim bëhet në faqen zyrtare në internet. Për çdo dallim mes versioneve, mbizotëron ai në gjuhën shqipe.*

Departamenti për Politika Makroekonomike dhe  
Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar  
Njësia e Makroekonomisë  
Maj 2018